

në Shqipëri personalitetet më të njohura të jetës amerikane, jeta me Sevasti Qirjaqin dhe kontributi i jashtëzakonshëm për atdheun



Falk Konica



Fan Stilian Noli

Kristo Dako

Njeriu që mbeti nën hijen e Nolit dhe Konicës edhe pse kishte të njëjtat vlera si ta. Historia e tij zbardhet pas më shumë se 50 vjetësh

marrë pjesë në punimet e saj, Kristo Dako i dërgoi atij një telegram në Romë në emër të 80 mijë shqiptarëve që jetonin në SBA, me anën e të cilit i lutej Presidentit që t'i kërkonte qeverisë italiane të bashkojë plotësisht me parimet e tyre të mëdha dhe të shenja, për të shtruar një themel të drejtë për kombin tonë të shumëvujtur pa asnjë farë protektorati edhe me kufijtë e saj etnologjikë dhe natyralë. Pas këtij telegrami të shkurtër më 18 janar 1919, ai i dërgon telegramin e dytë, ku thuhet: "I drejtohem shkëlqesisë suaj për të kërkuar të drejtat e kombit tonë pa miq dhe pa përkrahje dhe të mbrohet pavarësisht e plotë dhe integriteti i Shqipërisë, duke i restauruar dhe garantuar në emër të parimit të kombësisë dhe vetëvendosjes për

hir të paqes në Ballkan". Kristo Dako shpresonte të Presidenti Wilson edhe në sajë të njohjeve që ai kishte me të personalisht. Duke folur në emër të të gjithë shqiptarëve të Amerikës, ai parashtronte edhe njëherë idenë e përsëritur në mënyrë të vazhdueshme nga ana e tij, se asnjë problem nuk do të gjente zgjedhje në Ballkan, po nuk u morën parasysh të drejtat dhe kërkesat shqiptare. "Gpëtim i Shqipërisë nga fqinjët ose vënia e saj nën protektoratin e një shteti të madh ose të vogël, do të jetë shkak për turbullira në Ballkan. Parimi i Ballkanit për ballkanasit duhet të zbatohet pa anësi, pa favorizim, sepse vetëm kështu mund të vendoset paqja dhe rendi e të sigurohet zhvillimi i lirë dhe i gëzuar i këtyre popujve", shpre-

hej Dako. Nën cilësinë e përfaqësuesit të Këshillit Kombëtar Shqiptar, ai shprehte bindjen se "Presidenti Wilson do të merrte përsipër barrën për të mbrojtur kombet e vogla. Por në kohën kur Konferenca e Paqes kishte vetëm 9 ditë që kishte filluar punimet e saj, një ngjarje e papritur tronditi lëvizjen shqiptare. Ismail Qemali më 27 janar 1919 vdiq në Peruxhia të Italisë. Në atë kohë Dako do të shkruajë në gazetën "Albania" artikullin me titull "Shqipëria në zi". Konferenca e Paqes as e shtroi dhe as e përfshiu në programin e saj çështjen shqiptare. Por Dako bashkë me bashkëshorten e tij, Sevasti Qirjaqi, do të vazhdonin përpjekjet e tyre për të qenë në tryezën ku do debatoheshin çështjet e nxehta.

zbulimi

Vajza e Vangjush Mios, gjen aparatin e të atit

Gjendet një aparat shumë i vjetër fotografik, i përdorur nga "Piktori i Popullit", Vangjush Mio. Aparati fotografik zotërohej nga një fotograf i vjetër korçar, i cili së fundi i ka bërë të ditur vajzës së piktorit, Rozeta Mio, ekzistencën e tij (aparati) dhe ia ka dorëzuar atë. Tashmë, aparati fotografik së bashku me një pjesë të mirë të koleksionit të veprave të artistit të njohur korçar zotërohen nga vajza e Vangjush Mios. Aparati mendohet të ruhet në shtëpinë muze të "Piktorit të Popullit", Vangjush Mio, por sipas vajzës së tij, Rozeta Mio, "shtëpia-muze, e shpallur e tillë që prej 40 vitesh, nuk ruhet në gjendjen e duhur". Vajza e piktorit thotë se dhe numri i vizitorëve nuk është i kënaqshëm. Vizitorët janë të pakët në numër dhe kryesisht janë të huaj ose të ardhur nga rrethet e tjera të vendit. Krahas pikturës, fotografia ka qenë një pasion për Vangjush

Mion dhe këtë e dëshmon dhe aparati që ai ka përdorur për të fiksuar në celuloid pamje të ndryshme dhe peizazhe të rajonit të Korçës. Mësohet se aparati i gjetur është përdorur nga Mio për shumë vite në "kooperativën" e fotografëve dhe më pas ai ka kaluar në duart e fotografit të vjetër korçar, që së fundi vendosi t'ia dorëzoi atë vajzës së piktorit. "Piktori i Popullit", Vangjush Mio është një nga krenaritë e qytetit të Korçës. Qendra kulturore e qytetit mban emrin e tij. Në shtëpinë muze të piktorit ruhen 57 punime të tij të ekspozuara në studion e tij të punës dhe në dy dhoma të tjera, ndërkohe që rreth 62 punime të piktorit ruhen në Galerinë e Artit, në Korçë. Në muajin prill të vitit 1994, 21 piktura që ruheshin në shtëpinë e "Piktorit të Popullit" u vudhën për mungesë të sigurisë dhe ende nuk janë gjendur.



Aparati fotografik i përdorur nga Vangjush Mio

Rachele De Felice rrëfen për "Shqip" udhëtimin në Malësinë e Shkodrës Britanikët e OXFAM, fonde për "Urën e Shtrenjtë"



Vullnetarët britanikë

NGALONDRA MUHAMED VELIU

Një grup vullnetarësh britanikë nga organizata bamirëse OXFAM janë përfshirë në një fus hatë mbledhje fondesh për ndërtimin e një ure në Malësinë e Shkodrës. Ata po mundohen të sigurojnë një fond prej 1 mijë sterlinash 26 milionë lekë të vjetra për ndërtimin e "Urës së Shtrenjtë". Mungesa e urës ka bërë që një fshat i tërë në këtë zonë të thellë veriore në Shqipëri të jetë i ndarë në dy pjesë.

Problemet shtohen akoma më shumë gjatë dimrit, kur zona izolohet nga bora dhe shirat në pranverë. Disa vite më parë fshatarët e zonës përdornin një urë të vjetër guri, e cila është shembur. Tani tyre u duhet që të kalojnë përmes disa platformave prej hekuri, që lidhin fshatin me pjesën veriore të tij.

Sipas faqes zyrtare të OXFAM, në seksionin "Albanian bridge" (ura shqiptare) thuhet se komuniteti i kësaj zone nuk ka para për të ndërtuar urën.

Platformat e hekurit, që përdoren si urë provizore, nuk janë të sigurta. Vësh-tirësit për banorët e zonës bëhen më të mëdha në pranverë kur shkrit bora dhe lumi del nga shtrati, duke mbuluar urën provizore dhe izoluar ata nga pjesa tjetër e botës për javë të tëra. Britanikët i ka shqetësuar fakti se nga mospasja e kësaj ure, shqiptarëve të kësaj zone u mungon infermeria e fshatit, fëmijët mbeten pa shkollë etj.

Sipas vullnetarëve të OXFAM, që kanë vizituar zonën dhe kanë ngritur një projekt për ndërtimin e urës, komuniteti i harruar i kësaj zone është në nevojë të madhe për ndërtimin sa më parë të saj. Ata kanë gjetur forcën punëtoresh për ndërtim, por banorët lokalë nuk kanë para për blerjen e materialeve. Nga projekti rezulton se për ndërtimin e një ure të fortë dhe solide duhen 1 mijë paund. Nëse gjithçka shkon sipas planit, banorët e këtyre anës do të shkelin në të pranverën e vitit 2007, ku do të fillojë ndërtimi.

Flet Rachele De Felice, iniciatorja e projektit:

"Sjellja e shqiptarëve i imponoi dëshirën për t'i ndihmuar".

Iniciatore e këtij projekti është Rachele De Felice, e cila po kryen doktoraturën në Universitetin e Oksfordit. "E nisa këtë projekt, sepse pata një eksperiencë shumë të jashtëzakonshme gjatë qëndrimit tim dyvjar në Shqipëri. Ndjeva brenda meje se duhej t'i riktheja dikja këtij vendi dhe njerëzve atje", thotë De Felice në fillim të bisedës së saj me "Shqip". Sipas saj, të gjitha fshatrat që vizitoi ishin interesante, por në veçanti çështja e nevojës së ndërtimit të "Urës së Shtrenjtë" pushtoi zemrën e vajzës me origjinë italiane. De Felice ka mbetur e mahnitur nga mikpritja shqiptare, duke e komentuar kështu: "Takova njerëz të mrekullueshëm. Ëngra së bashku me ta, ku djathi në veçanti ishte shumë i mirë, pale pastaj rakia që na u servir me mjaltnin e rrallë të kësaj zone".

Për De Felice surpriza më e bukurë është udhëtimi ka qenë kur ndër të tjera banorët lokalë, duke bërë shaka, i thanë nëse

donin t'i gjenin një burrë të mirë shqiptar. "E gjithë kjo ngjarje më bëri të kuptoj se mes meje dhe atyre ishte ndërtuar një marrëdhënie e ngushtë", rrëfen ajo.

Duke folur më tej rreth projektit të ndërtimit të urës, De Felice sqaron se që në fshatin e parë që ajo vizitoi, u ndje mirë, dhe ky ishte një paralajmërim për vijueshmëri të mbarë në të gjithë udhëtimin.

"E pamë që ndërtimi i urës ishte çështje urgjente dhe kjo më shtyu që të filloj këtë projekt. Është një punë e madhe për mua, pasi paralel unë po kryej doktoraturën, por e ndje se ia vlen, është dikja që ia vlen.

U impresionova shumë nga banorët e "Urës së Shtrenjtë" dhe Shqipëria në përgjithësi, se si ata janë të gatshëm të përveshin mëngë të tërë për të realizuar gjërat. Është një element i përbashkët që vumë re në të gjitha fshatrat që pamë. Njerëzit atje ishin të gatshëm të bënin dikja, të rrisnin prodhimet në agrikulturë, por shpeshherë mungojnë iniciativat në të për të filluar dikja, makinieritë ose përvojat. E nëse shqiptarët nisnin dikja, nuk ka gjë që i ndalon ata. Për shembull, në zonën e "Urës së Shtrenjtë" njerëzit kanë bërë një progres të madh pas ndihmave të vogla dhënë nga OXFAM, duke prodhuar tonelata të tëra mjaltni, pas krijimit dhe mirëfunksionimit të kooperativave.

Italia De Felice thekson se ajo personalisht i gjeti shqiptarët jashtëzakonisht miqësorë, duke shtuar: "Mbasa nga që unë isha italiane, me mund të merreshim vesh në italisht gjithashtu edhe anglisht, gjë e cila na bëri të ndanim njohuri tona për muzikën, sportin dhe kulturën. Mendoj se ne jemi të ngjashëm me njëri-tjetrin në shumë gjëra, me jemi ngrohësish miqësorë, të hapur, duke i dhënë shumë rëndësi miqësisë dhe lidhjeve familjare". Italia De Felice "dashuruar" me vendin tonë në fund të bisedës jep një vlerësim për cilindo shqiptar që do ta lexojë e do ta bëjë të ndjehet mirë. Ajo tha:

Rachele De Felice



"Tani e kuptoj se si Shqipëria ka qenë kaq e pafat në dekadën e shkuar, duke sjellë një zhvillim të avashtë. Mendoj se vendi juaj ka kapacitete të shkëlqyera njerëzore për të qëndruar me krenari përkrah vendeve të tjera në Bashkimin Evropian".